



Prishtinë: 12.07.2018
Kodi i ZRRE-së: V_1013_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët;
- Rekomandimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_1823_06_17**;

në seancën e mbajtur më datë 12.07.2018, nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** ankesa e konsumatorit Q. S. E. D. B. - I.L. nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura në këtë rekomandim.
- II. **OBLIGOHET** KESCO që konsumatorin me shifër DPR – 90034541 ta shkarkoj nga korrigjimet nr. 85417DPR-90034541 dhe nr.85416DPR-90034541 të datës 10.05.2016 në vlerë **6,530.71€**.

A r s y e t i m

Pranë Zyrës së Rregullatorit për Energji me datë 02.12.2016 konsumatori Q. S. E. D. B. - I L. ka parashtruar ankesë me të cilën ka kundërshtuar përgjigjen e Departamentit për Konsumator në KESCO lidhur me faturimin shtesë të bërë nga KESCO në vlerë prej 6530.71€.

Bordi i ZRRE-së, me qëllimit të vërtetimit të plotë gjendjes faktike e cila është iniciuar nga palët në kontest lidhur me pikën matëse të theksuar më lartë ka shqyrtuar dhe analizuar në detaje të gjitha dëshmitë e mbledhura për veprimet e ndërmarra nga palët në kontest lidhur me këtë pikë matëse.

Me datë 22.06.2010 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë bërë inspektimin e pikës matëse, ku kanë demontuar grupin matës nr.28387920, e gjendje të njehsorit elektrik aktiv TL=3343.64 kWh dhe TU=2722.80 kWh dhe kanë vendosur për matje grupin matës nr.96256447 me gjendje të njehsorit elektrik aktiv TL=00000 kWh dhe TU=00000 kWh.

Provë: Procesverbali i montimit dhe demontimit të grupit matës mbi kontrollimin – pranimin e grupit matës nr. 006528 i datës 22.06.2010

Punëtorët e autorizuar të KEDS-it me datë 21.01.2016 kanë inspektuar grupin matës të konsumatorit nr. 96256447, ku përveç evidentimit të të dhënave teknike të pikës matëse kanë konstatuar se kyçjet në njehsorin elektrik kanë qenë gabim pasi që: Tensioni i fazës së parë me rrymën e fazës së tretë, tensioni i fazës së dytë me rrymën e fazës së parë dhe tensioni i fazës së tretë me rrymën e fazës së dytë, si dhe të gjitha rrymat kanë qenë të lidhura gabim. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar se bëhet rregullimi i kyçeve, si dhe duhet të bëhen korrigjimet sipas AMR-së.

Provë: Raporti mbi kontrollimin – pranimin e grupit matës nr. 030607 i datës 21.01.2016



Departamenti i Faturimit në KESCO me datë 10.05.2016 përmes urdhër lejimeve nr. 85417DPR-90034541 dhe 85416DPR-90034541 kanë ngarkuar konsumatorin me ngarkesë shtesë prej 2,912.24€ dhe 3,618.47€ bazuar në procesverbalin e KEDS-it nr.030607 i datës 21.01.2016 pasi që rrymat kanë qenë në kahje të kundërt dhe ka pasur përzjerje të rrymave dhe tensioneve, nga ku rrjedh $K=1.53$ apo faktori korigjues $Y=0.533$ dhe se kjo ngarkesë shtesë bëhet për periudhën 1 vjeçare.

Provë: Korigjimet nr. 85417DPR-90034541 dhe nr.85416DPR-90034541 të datës 10.05.2016

Me datë 05.10.2016 konsumatori ka parashtruar ankesë në KESCO duke kundërshtuar ngarkesën shtesë të KESCO bërë me datë 10.05.2016 në vlerë prej 6,530.71€ dhe ka kërkuar që të rishqyrtohet ngarkesa plotësuese.

Provë: Ankesa e konsumatorit në KESCO datë 05.10.2016

Departamenti për Konsumator në KESCO me datë 28.10.2016 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar në arsyetimin se sipas procesverbalit nr.030607 të datës 21.01.2016, si dhe të dhënave të AMR-së njehsori elektrik ka qenë i lidhur gabimisht, rrymat kanë qenë në kahje të kundërt dhe ka pasur përzjerje të rrymave dhe tensioneve, nga ku rrjedh faktori korigjues duhet të jetë $Y=0.533$ dhe se kjo ngarkesë shtesë bëhet për periudhën 1 vjeçare.

Provë: Përgjigja e Departamenti për Konsumator në KESCO me datë 28.10.2016

I pakënaqur me përgjigjen e KESCO-s konsumatori ka parashtruar ankesë në ZRRE duke kundërshtuar ngarkesën shtesë të ngarkuar nga KESCO me datë 10.05.2016, me arsyetimin se në asnjë rast nuk është bërë ndërhyrje në kyçjet e njehsorit, si dhe janë bërë kontrollime të rregullta nga ekipet e KEDS-it.

Provë: Ankesa e konsumatorit në ZRRE datë 02.12.2016

Bordi i ZRRE-së ka analizuar procesverbalin e montimi dhe demontimit të grupit matës nr.006528 të datës 22.06.2010, në të cilin procesverbal punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë bërë inspektimin e pikës matëse dhe kanë demontuar grupin matës nr.28387920 me gjendje të njehsorit elektrik aktiv $TL=3343.64$ kWh dhe $TU=2722.80$ kWh dhe kanë vendosur për matje grupin matës nr. 96256447 me gjendje të njehsorit elektrik aktiv $TL=00000$ kWh dhe $TU=00000$ kWh. Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se sipas të dhënave të evidentuar në procesverbal konstatohet se ekipi i KEK-ut ka bërë të gjitha matjet e nevojshme të parapara me kodin e matjes dhe se nuk ka pasur ndryshime në matje. Po ashtu ekipi i KEK-ut ka evidentuar që leximi i shpenzimeve në njehsorin e ri të vendosur bëhet nga distanca si dhe kanë bërë vulosjen e njehsorit elektrik me vulat distributive.

Provë: Procesverbali i montimit dhe demontimit të grupit matës mbi kontrollimin – pranimin e grupit matës nr. 006528 i datës 22.06.2010

Punëtorët e autorizuar të KEDS-it me datë 21.01.2016 kanë inspektuar grupin matës të konsumatorit nr. 96256447, ku përveç evidentimit të të dhënave teknike të pikës matëse kanë konstatuar se kyçjet në njehsorin elektrik kanë qenë gabim, përkatësisht: Tensioni i fazës së parë me rrymën e fazës së tretë (U_1 me I_3), tensioni i fazës së dytë me rrymën e fazës së parë (U_2 me I_1) dhe tensioni i fazës së tretë me rrymën e fazës së dytë (U_3 me I_2), si dhe të gjitha rrymat kanë qenë të lidhura gabim. Bordi i ZRRE-së thekson se në procesverbalin e lartcekur nuk është evidentuar arsyeja e ndërrimit të kahjeve të rrymave përkatësisht problemet e paraqitura para ndërrimit apo ndryshimit të kyçjeve duke pasur parasysh se leximi i pikës matëse përkatësisht njehsorit elektrik nr.96256447 nga fillimi/periudha 06/2010 është bërë nga distanca me AMR dhe se të gjitha shpenzimet regjistrohen dhe monitorohen në kohë reale. Po ashtu Bordi i ZRRE-së vëren se furnizimi i konsumatorit në fjalë bëhet përmes **TS 35/10kV, "PR2"** e që duke pasur parasysh që në dalje të TS gjendet njehsori matës për energjinë dalëse e cila e furnizon TS e konsumatorit, atëherë është e pamundur që nga periudha 06/2010 deri në periudhën 01/2016 nuk janë vërejtur humbjet e mundshme të energjisë të shkaktuara nga konsumatori "Q.S.E. D. B". Po ashtu në dokumentacionin e ofruar nga KEDS nuk është potencuar ankesa e mundshme nga konsumatori për shkak të ndërrimit të kahjeve të rrymave apo çfarëdo



problemi tjetër i cili mund të ishte shkaktuar si rrjedhojë e ndërrimit të kahjeve të rrymave. **Provë:** Raporti mbi kontrollimin – pranimin e grupit matës nr. 0230607 i datës 21.01.2016

Bordi i ZRRE gjithashtu ka analizuar edhe rrjedhën e përgjithshme të energjisë elektrike dhe konstaton se konsumatori ka luhatje për periudha të ndryshme kohore. Sipas analizave të bëra shpenzimit të energjisë elektrike para dhe pas ndërhyrjeve të ekipeve të KEDS-it konstatohet se konsumatori për periudha të njëjta kohore ka dallime në shpenzimin e energjisë elektrike krahasuar edhe me njehsorin elektrik nr.28387920 i cili ka qenë i vendosur për matje nga periudha 04/2004 deri në periudhën 06/2010, por që ZRRE vëren se konsumatori nuk ka ndryshim të shpenzimit të energjisë elektrike me njehsorin nr.28387920 krahasuar me shpenzimet e njehsorit nr.96256447 deri në momentin e ndërrimit të kyçjeve. Pra Bordi i ZRRE-së thekson se sipas rrjedhës së energjisë elektrike konstatohet se pas ndërrimit të kyçjeve nga ekipet e KEDS-it mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike periudha 02/2016 - 10/2016 është 13,439 kWh (aktiv), kurse për periudhën e njëjtë para ndërhyrjes 02/2015 - 10/2015 është 8,050 kWh (aktiv). Sipas të dhënave të paraqitura vërehet se kemi ngritje të shpenzimit prej 66% pas ndërrimit të kyçjeve.

Provë: Rrjedha e energjisë elektrike Aktive

ZRRE ka shqyrtuar korigjimin e bërë nga Departamenti i faturimit në KESCO nr.85417DPR-90034541 dhe nr.85416DPR-90034541 të datës 10.05.2016 për periudhën njëvjeçare e i cili është bërë bazuar në nenin 4.11.1 të Kodit të Matjes së OSSH-së dhe konstaton se kjo nuk qëndron, pasi që neni 4.11.1 përcakton rastet kur njehsori elektrik është teknikisht jo në rregull, ku edhe thuhet se: “Pas testimit të pajisjeve matëse dhe pasi që vërtetohet kufiri i pasaktësisë përpilohet raporti për gjendjen dhe vlerat e testuara të njehsorit. Pavarësisht a është gabimi në plus ose minus dhe tejkalon vlerën 3 herë e klasës së saktësisë (p.sh. për njehsorët e drejtpërdrejtë klasa e saktësisë është 2.0 , kufiri i lejuar do të ishte 6.0%) atëherë bëhet ri-llogaritja e energjisë dhe përmirësimi i faturimit për 12 (dymbëdhjetë) muajt e fundit përkatësisht 6 muajt e fundit për konsumatorët shtëpiak. Kur vendoset njehsori kontrollues dhe kur vërtetohet se dallimi në lexim është 1.5 herë më i lartë, atëherë veprohet siç u tha më lart”.

Provë: Korigjimet nr. 85417DPR-90034541 dhe 85416DPR-90034541 datë 10.05.2016

Bazuar në kodin e matjes përkatësisht nenin 3.9.4 dhe 3.9.5 (Testimi i njehsorëve me pajisje portabël), si dhe nenin 4.3.2 përcaktohen qartë detyrimet e OSSH-së lidhur me inspektimin dhe testimin e njehsorëve brenda periudhave të caktuara kohore, si dhe përgjegjësinë mbi operimin dhe mirëmbajtjen e njehsorëve elektrik. Në nenin 3.9.4 thuhet se: “Njehsorët indirekt multifunksional të cilët kyçen përmes TMRR dhe TMT duhet që së paku 1 (një) herë në vit ose kur të merret ankesa, cilado kohë që është më e shkurtër të testohen”, kurse në nenin 3.9.5 thuhet se: “Testimi i përbashkët në prezencë të përfaqësuesit të konsumatorit kurdo që është e mundur posaçërisht TMRR, TMT, Njehsorët e kërkesës maksimale (të ashtuquajturit GM multifunksional) duhet të bëhet në bazë vjetore, ose në çdo gjashtë muaj varësisht nga rasti që paraqitet”, e që në rastin e konsumatorit Q.S.E D. B. asnjëri rast nuk është respektuar, kurse në nenin 4.3.2 thuhet se: “Operimi dhe mirëmbajtja e Sistemit të njehsorit përfshinë instalimin e bërë në bazë të standardeve të kërkuara, mirëmbajtjen e rregullt, kontrollimin e TMRR, TMT, dhe njehsorëve tjerë, instalimin e përçuesve, terminalet, shtrirjen e mirëfilltë të kabllave, mbrojtjen, pastrimin dhe gjendjen e lidhjeve të kutive të njehsorëve, gjendjen e plumbave, leximin ditor të rregullt të njehsorëve si dhe nxjerrjen e të dhënave nga pajisja për lexim, nga Qendra Grumbulluese e të Dhënave si dhe kushtimit të vëmendjes për ndonjë prishje eventuale të sistemit të njehsorëve matës”. Bazuar në dokumentacionin e ofruar nga KEDS konstatohet se nenet 3.9.4 dhe 3.9.5 nuk janë respektuar nga KEK dhe KEDS për periudhën 06/2010 deri në periudhën 01/2016 pasi që nuk është ofruar asnjë dokument me të cilët vërtetohet shqyrtimi periodik i grup matësit të konsumatorit, kurse neni 4.3.2 vërteton përgjegjësinë e OSSH-së për grup matësin nr. 96256447. Po ashtu me Ligjin për Energjinë Elektrike, neni 54 paragrafi 1 thuhet se “Pajisjet matëse për matjen e energjisë elektrike janë pronë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Operatorit të



Sistemit të Shpërndarjes, siç përcaktohet në Ligjin për Energjinë”, e që duke pasur parasysh edhe faktin që njehsori si dhe kyçjet janë bërë nga ekipi i KEK-ut me datë 22.06.2010 vërteton se konsumatori nuk ka pasur çasje në ndërhyrjen e matjes së njehsorit elektrik.

Bordi i ZRRE-së duke pasur parasysh të gjitha faktet e përmendura me lartë, procesverbalin e montimit dhe demontimit të grupit matës mbi kontrollimin – pranimin e grupit matës nr. 006528 i datës 22.06.2010, raportin mbi kontrollimin – pranimin e grupit matës nr. 0230607 i datës 21.01.2016 mos respektimin e neneve 3.9.4 dhe 3.9.5 të Kodit të matjes që kanë të bëjnë me inspektimin dhe testimin e pajisjeve matëse multifunksionale (GP) brenda periudhës së caktuar, nenin 4.3.2 të Kodit të matjes me të cilin është e përcaktuar përgjegjësia mbi operimin dhe mirëmbajtjen e njehsorëve elektrik, si dhe nenin 54 paragrafin 1 të Ligjit për Energjinë Elektrike, konstaton se KESCO nuk ka arritur të argumentojë se fatura shtesë prej 6,530.71€ është si rezultat i ndërrimit të kahjeve të kyçeve, andaj vendos që të aprovon ankesën e konsumatorit, përkatësisht konsumatori duhet të shkarkohet nga korrigjimet nr. 85417DPR-90034541 dhe 85416DPR-90034541 datë 10.05.2016 në vlerë **6,530.71€**.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12.07.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versionin në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit: Q. S. E. D. B. - I. L.
- KESCO-së dhe
- Arkivit të ZRRE-së.